



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KUÇOVË

## FORMULARI I NJOFTIMIT PARAPRAK TË FITUESIT

Për : “Zdravo” shpk

me adresë : Lagja Xhevdet Nepravishta, ish godina e plastmasit..

**LUSHNJE**

Procedura e prokurimit : Procedurë e Hapur – Punë ndërtimi.

Numri i referencës së procedurës : NR REF-39774-08-25-2022.

Përshkrim i shkurtër i kontratës , objekti : “Ndërtim shtesë kati në objekt ekzistues për strehim social”, me fond limit : 19 617 165 (*nëntëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e pesë*) lekë pa tvsh.

Afati për ekzekutimin e kontratës : 4 (katër) muaj duke filluar nga data e dorëzimit të sheshit të punimeve.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

Çmimi më i ulët **X**

Njoftojmë se në procedurën e prokurimit kanë ofertuar 2 (dy) operator ekonomik dhe konkretisht si më poshtë :

1. “Zdravo” shpk me Nr NIPT-i J84003411K me ofertë ekonomike :
  - 18 640 630 (*tetëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e dyzetë mijë e gjashtëqind e tridhjetë*) lekë pa tvsh.

2. “Fled” shpk me Nr NIPT-i K17621104C me ofertë ekonomike :

- 16 120 885 (*gjashtëmbëdhjetë milion e njëqind e njëzetë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e pesë*) lekë pa tvsh.

\* \* \*

**Është skualifikuar operatori ekonomik ofertues si më poshtë :**

1. “Fled” shpk me Nr NIPT-i K17621104C me arsyet si më poshtë :

- Nuk plotëson pikën 2.3.10 të DST-së, gërma e).  
Mjetet e paraqitura nga operatori ekonomik ofertues “Fled” shpk në shtojcën 8 të formularit përmbledhës të vetdeklarimit janë aktive në kontratën e lidhur midis autoritetit kontraktor Bashkia Kuçovë dhe “Fled” shpk në objektin “Rikualifikimi urban i lagjes Llukan Prifti”. Për rrjedhojë çënohet zbatimi i kontratës së re për sa kohë që mjetet janë të deklaruar në një tjetër kontratë.
- Nuk ka paraqitur dokumenta dhe nuk ka deklaruar në formularin përmbledhës të vetdeklarimit për mjetin “Pompë penobetoni”.
- Nuk plotëson pikën 2.3.10 të DST-së dhe konkretisht për fabrikën e prodhimit të dyerve, dritareve dhe PVC duralumini. Ka paraqitur vetëm kontratën e furnizimit. Mungon çertifikata e pronësisë ose kontrata blerje e makinerisë që të vërtetojë lidhjen e shoqërisë prodhuese me distributorin. Gjithashtu mungojnë dhe çertifikatat e konformitetit ISO 9001:2015 dhe ISO 14001:2015 ose ekuivalente të saj.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë “Zdravo” shpk se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 18 640 630 (*tetëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e dyzetë mijë e gjashtëqind e tridhjetë*) lekë pa tvsh është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

**Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 23 / 09 / 2022.**

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**Kreshnik HAJDARI**